



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 622/ Prot.

Tiranë, më 06.03.2026

VENDIM

Nr. 42, Datë 25.02.2026

**“PËR NDËRPRERJEN E CAKTIMIT TË PËRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM BERAT”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

|                    |                     |
|--------------------|---------------------|
| 1. Mirela BOGDANI  | Kryetar             |
| 2. Erind GERMENJI  | Zv/kryetar          |
| 3. Sokol STOJANI   | Anëtar              |
| 4. Zeqir HODA      | Anëtar (në mungesë) |
| 5. Arta MANDRO     | Anëtar (në mungesë) |
| 6. Ledina RIZA     | Anëtar (në mungesë) |
| 7. Moisi DUDA      | Anëtar              |
| 8. Vatë STAKA      | Anëtar              |
| 9. Olger EMINAJ    | Anëtar              |
| 10. Erind MERKURI  | Anëtar              |
| 11. Erion FEJZULLA | Anëtar              |

Në mbledhjen plenare të datës 25.02.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për ndërprerjen e caktimit të përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”**



## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 622, dt. 25.02.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pasi dëgjoi Relatorin, z. Sokol Stojani si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,

### V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim Këshilli*) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Pozicioni i drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat është vakant që prej datës 27.03.2024, pas largimit nga detyra të ish-drejtuesit të kësaj zyre prokurorie<sup>1</sup>, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar. Për këtë arsye, Këshilli ka shpallur në mënyrë të përsëritur plotësimin e këtij vendi vakant përmes ngritjes në detyrë, por është konstatuar se për këtë pozicion nuk ka patur shprehje interesi nga kandidatët.
3. Aktualisht, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat ka në organikë 8 (tetë) prokurorë nga të cilët në detyrë janë 6 (gjashtë). Nga verifikimet e kryera rezulton se, asnjëri prej gjashtë prokurorëve në detyrë në këtë zyrë prokurorie, nuk plotëson kushtin e vjetërsisë prej 7 vitesh si magjistrat, për t'u caktuar përkohësisht si Drejtues.
4. Për rrjedhojë, me qëllim garantimin e funksionimit dhe mbarëvajtjes së punës në këtë zyrë prokurorie, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka caktuar përkohësisht në pozicionin e Drejtuesit në këtë zyrë të Prokurorisë, prokurorin Edina Kurti, fillimisht me Vendimin nr. 42, datë 29.03.2024, "Për caktim të përkohshëm", të Këshillit.

Në vazhdim, Këshilli ka ndjekur të njëjtën procedurë edhe më pas, duke caktuar përkohësisht prokurorin në fjalë në të njëjtën detyrë sipas vendimeve respektive, dhe së fundi, me Vendimin nr. 380, datë 19.12.2025, "*Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat*", të Këshillit, është vendosur caktimi i përkohshëm i prokurores Edina Kurti në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për periudhën nga data 30.12.2025 deri në 30.03.2026.

5. Në datë 26.01.2026, prokurorja Edina Kurti i është drejtuar me një kërkesë Këshillit, nëpërmjet së cilës ka parashtruar se, për arsye familjare në veçanti, shëndetësore, e ka të

---

<sup>1</sup> I caktuar përkohësisht në detyrën si drejtues në këtë zyrë prokurorie





pamundur vijimin e caktimit të përkohshëm në detyrën e Drejtueses në Prokurorinë Berat. Në këto kushte, ajo ka kërkuar ndërprerjen e caktimit të përkohshëm në këtë funksion dhe vijimin e ushtrimit të detyrës së prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ku ajo ka emërimin e përhershëm.

Njëkohësisht, prokurori Edina Kurti ka informuar Këshillin se, në bazë të Urdhrit nr. 39, datë 30.09.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë Berat, në këtë zyrë prokurorie është emëruar në funksionin si Zëvendësdrejtues, prokurori i kësaj prokurorie, z. Eni Çulli.

6. Duke qenë se me Vendimin nr. 35, datë 05.02.2026, "Për shpalljen e vendit vakant për Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat", Këshilli ka shpallur vendin vakant për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë Berat dhe duke pasur parasysh se kjo zyre prokurorie aktualisht mund të ushtrojë veprimtarinë administrative dhe menaxheriale nga Zëvendësdrejtuesi i saj, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se ndërprerja e caktimit të përkohshëm në funksionin si Drejtues të prokurorit Edina Kurti nuk ndikon në vijimësinë e punës në Prokurorinë Berat.
7. Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, referuar Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019 "Rregullore "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", i ndryshuar i propozoi Këshillit që, prokurorit Edina Kurti t'i ndërpritet caktimi i përkohshëm si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 149/a, pika 1, germa "a", të Kushtetutës, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2 dhe 189, pikat 1, germa "a" dhe 3, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 90, të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

#### **VENDOSI:**

1. Ndërprerjen e caktimit të përkohshëm në pozicionin si Drejtues të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, të prokurorit Edina Kurti.
2. Të njoftohet për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe prokurori Edina Kurti.



3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 25.02.2026.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR**  
Mirëla Bogdani

**ZV/KRYETAR**  
Erind Germenji

**ANËTAR**  
Sokol Stojani

**ANËTAR**  
Moisi Duda

**ANËTAR**  
Vatë Staka

**ANËTAR**  
Olger Eminaj

**ANËTAR**  
Erind Merkuri

**ANËTAR**  
Erion Fejzulla